



VENDIM

Nr. 50 Datë 03.05.2013

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË EN.KU SH.P.K ME NR. 10, SERIA
PV03P, LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE KOMISIONEREVE
TE ERE-S NR. 20, DT. 19.01.2003, MODIFIKUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE-S NR. 86, DATE 17.07.2008**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa”b”, pika 3 pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03 .05.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “EN.KU” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.10, Seria PV03P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 20, date 19.01.2003, modifikuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s nr. 86, date 17.07.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “EN.KU” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, germa “a”:**

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

- **Neni 15, pika 4, germa “b”:**

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për te kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e liçensës së shoqërisë “EN.KU” me numër Nr.10, seri PV03P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec “Bicaj” me fuqi 100 KW, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 20, date 19.01.2003, modifikuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 86, date 17.07.2008.
2. Fuqia e instaluar e Hec “Bicaj” nga 100 KW të bëhet 3.1 MW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI

Ne mungese dhe me porosi

Entela SHEHAJ